REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 6353 Prot. Tiranë, më 09 / 11 /2026

Lënda: Mbi Raportin për vitin 2026 të Komisionit Europian për Shqipërinë

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Për dijeni: **Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë**
Ambasadave të vendeve anëtare të Bashkimit Europian në Tiranë

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Shqipëria ndodhet në një moment kyç në procesin e integrimit europian, i cili duhet të shërbejë edhe si një mundësi për të forcuar demokratizimin e institucioneve shqiptare, përfshirë funksionimin demokratik të Kuvendit të Shqipërisë. Për fat të keq, kjo jo vetëm që nuk po ndodh, por mazhoranca në Kuvend, përmes veprimeve dhe mosveprimeve të saj, po synon asgjësimin e rolit të opozitës në Parlament, duke cenuar rëndë parimet themelore të parlamentarizmit.

Qartësisht, ekziston një përpjekje për të bashkuar shtetin me partinë në pushtet. Shumica parlamentare, dita-ditës, po e trajton Parlamentin si një institucion njëpartiak, ku vendimet nuk diktohen nga forca e arsyes, përgjegjësia kushtetuese, të drejtat ligjore apo Rregullorja e Kuvendit, por vetëm nga forca e numrave në Kuvend.

Duke e përjashtuar tërësisht opozitën nga procesi i përzgjedhjes dhe emërimit në institucionet e pavarura kushtetuese apo ato të krijuara me ligj, mazhoranca ka arritur të politizojë çdo institucion të pavarur dhe të kontrollojë 100% të emërimeve në këto institucione, përfshirë edhe organet kolegjiale, për të cilat rregullat dhe tradita parlamentare kanë synuar një ndarje proporcionale të propozimeve për emërim ndërmjet mazhorancës dhe opozitës.

Shumica parlamentare vazhdon t'u mohojë deputetëve të opozitës ushtrimin e të drejtave të tyre parlamentare, duke i penguar në përmbushjen e detyrës së tyre për mbrojtjen e interesit publik. Deri më sot, kërkesat tona për zhvillimin e mocioneve me debat, zhvillimin e interpelancave me Kryeministrin apo ministrat, organizimin e seancave dëgjimore në komisionet parlamentare, si dhe ngritjen e komisioneve hetimore, janë refuzuar në shumicën dërrmuese të rasteve. Po ashtu, ju refuzoni të zbatoni vendimet e Gjykatës Kushtetuese edhe në rastet kur ato i japin të drejtë opozitës.

Nga ana tjetër, propozimet ligjore të deputetëve të opozitës, përfshirë projektligjet dhe amendamentet, refuzohen pa asnjë arsyetim, thjesht për faktin se janë paraqitur nga deputetë të opozitës. Madje, në disa raste është konstatuar se, pas refuzimit të një iniciative ligjore të propozuar nga deputetët e opozitës, i njëjti propozim është paraqitur nga një deputet i mazhorancës ose nga Këshilli i Ministrave dhe më pas është miratuar nga Kuvendi.

Për një kohë të gjatë, propozimet tona ligjore mbeten të pashqyrtuara, duke u mohuar deputetëve të opozitës të drejtën kushtetuese për të ndërmarrë iniciativa ligjore në funksion të interesit publik. Ky është një tregues i qartë se mazhoranca nuk është e interesuar për zhvillimin e një dialogu politik konstruktiv në Kuvendin e Shqipërisë dhe as për zhvillimin e debatit mbi idetë dhe alternativat e forcave të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Gjithashtu, përmes veprimeve të paprecedenta, në një numër të konsiderueshëm seancash plenare, votimi i projektligjeve është kryer pa iu nënshtruar paraprakisht procesit të debatit parlamentar. Projektligjet janë hedhur në votim pa u diskutuar më parë nga deputetët dhe pa u garantuar transparenca e nevojshme për qytetarët tanë. Nga ana tjetër, shqyrtimi i disa projektligjeve të caktuara është zhvilluar me urgjencë, brenda një kohe tepër të shkurtër dhe pa konsultime domethënëse me grupet e interesit.

Të gjitha këto shqetësime janë ngritur në mënyrë të vazhdueshme dhe zyrtare nga opozita në Kuvendin e Shqipërisë, përfshirë edhe nëpërmjet Raportit nr. 1579 Prot., datë 10.04.2026, të cilin ju keni vendosur ta injoroni, në vend që ta trajtoni me përgjegjësinë institucionale që ju dikton funksioni që ushtroni.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Raporti SWD(2026) 690, datë 4.11.2026, i Komisionit Europian për Shqipërinë, me të cilin opozita është njohur zyrtarisht, konfirmon të gjitha shqetësimet e përmbledhura më sipër dhe përbën një pasqyrë realiste të degradimit të parlamentarizmit në vend. Për ne, si opozitë parlamentare, ky Raport përbën një plan të mirëfilltë pune që duhet të zbatohet, nëse procesi i integrimit europian konsiderohet edhe nga mazhoranca parlamentare, njësoj si nga ne, si një proces nga i cili duhet të përfitojnë qytetarët shqiptarë dhe që përfaqëson një moment historik për demokratizimin e vendit.

Në mënyrë të përmbledhur, Raporti, lidhur me veprimtarinë e Parlamentit, konstaton se:

> *"Funksionimi i institucioneve demokratike në Shqipëri është pjesërisht i vënë në pikëpyetje, ndër të tjera, për shkak të një mjedisi politik thellësisht të polarizuar, kontrollit të kufizuar parlamentar mbi ekzekutivin, nevojës urgjente për reformë zgjedhore, dështimit të vazhdueshëm të Parlamentit për të zbatuar disa vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe mungesës së konsultimeve publike kuptimplota.*
>
> *Kontrolli i Parlamentit mbi ekzekutivin mbeti i dobët. Nuk pati debat kuptimplotë për programin e ri qeveritar në shtator 2025. Paraqitjet e ministrave në seancat e pyetjeve ishin të parregullta.*
>
> *Kërkesat e opozitës për ngritjen e komisioneve hetimore u refuzuan sistematikisht, pa debat. Pas një vonese të gjatë, Parlamenti votoi kundër kërkesës së SPAK-ut për heqjen e imunitetit të një deputeteje [...]. Kjo ngre shqetësime për kontrollin dhe balancën ndërmjet pushteteve, si dhe për barazinë para ligjit.*
>
> *Shumica vazhdoi të kundërshtojë dhe të vonojë zbatimin e disa vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.*
>
> *Projektligjet e paraqitura shpesh në çastin e fundit nga deputetët e shumicës dëmtuan cilësinë dhe transparencën e procesit legjislativ, duke anashkaluar shpesh konsultimin publik.*
>
> *Politizimi i emërimeve (Avokati i Popullit dhe Komisioneri) mbetet një çështje serioze. Avokati i Popullit u zgjodh vetëm me votat e shumicës, duke cenuar traditën e konsensusit ndërmjet partive.*

Komisioni (për Integrimin Europian) nuk drejtohet më nga opozita, gjë që kufizon dialogun ndërmjet partive dhe rolin e saj në procesin e anëtarësimit.
Komisioni i përbashkët parlamentar ad hoc për Reformën Administrative dhe Territoriale e përfundoi mandatin në korrik 2026, pa arritur konsensus ndërmjet dy palëve për reformën e hedhur në konsultim publik. Reforma u miratua në tetor 2026, mbi bazën e propozimit të shumicës. Reforma territoriale dhe administrative në vijim, e shoqëruar me një pririe drejt ricentralizimit, krijoi pasiguri për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve konfirmoi gjetjet paraprake. Sipas tij, zgjedhjet e përgjithshme të majit 2025 ishin konkurruese dhe u administruan në mënyrë profesionale, por u zhvilluan në një mjedis shumë të polarizuar dhe pa kushte të barabarta për garuesit. Raporti konstatoi gjithashtu se kuadri ligjor ofron një bazë të përshtatshme për zgjedhje demokratike, por disa mangësi dhe paqartësi cenojnë qartësinë ligjore dhe krijojnë pasiguri në zbatimin e tij. Raporti jep rekomandime për adresimin e këtyre mangësive.
Kuadri ligjor dhe institucional për zgjedhjet është përgjithësisht i përshtatshëm. Megjithatë, disa rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias mbeten ende të paadresuara. Nevojitet urgjentisht një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse, veçanërisht përpara zgjedhjeve vendore të vitit 2027.
Një komision parlamentar ad hoc, i ngarkuar me hartimin e reformës zgjedhore, zhvilloi mbledhjen e parë të punës në shkurt 2026. Ky komision garanton përfaqësim të barabartë të partisë në pushtet dhe të partisë kryesore opozitare, por nuk përfshin asnjë nga partitë e tjera opozitare, gjë që është për t'u ardhur keq. Komisioni ad hoc pritet të hartojë një ligj për financimin e partive politike, pas konsultimeve me palët e interesuara dhe me Komisionin e Venecias. Shqipëria duhet të sigurojë përputhshmërinë me të gjithë legjislacionin përkatës të BE-së në këtë fushë, përfshirë Rregulloren (BE) 2024/900 për transparencën dhe shënjestrimin e reklamave politike, duke marrë parasysh standardet demokratike europiane dhe ndërkombëtare."

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, kuptojmë qartësisht se mesazhi i Komisionit Europian është i qartë: pa llogaridhënie reale dhe pa respektimin e balancës ndërmjet pushteteve, rrugëtimi drejt BE-së mbetet i brishtë.

Opozita e ka përmbushur plotësisht rolin e saj në funksion të garantimit të demokracisë parlamentare efektive. Megjithatë, mazhoranca vazhdon të bëjë gjithçka për ta penguar ushtrimin e këtij roli. Më lejoni t'ju kujtoj se:

1. Lidhur me kontrollin e kufizuar parlamentar mbi ekzekutivin, ka qenë mazhoranca dhe ju personalisht që e keni asgjësuar këtë funksion kushtetues të Kuvendit. Mazhoranca ka refuzuar 6 kërkesa për ngritjen e komisioneve hetimore, duke mos pranuar asnjë prej kërkesave të pakicës parlamentare gjatë kësaj legjislature. Ndërkohë, ju personalisht keni refuzuar 11 kërkesa për zhvillimin e interpelancave me Kryeministrin, i cili nuk i është përgjigjur asnjë kërkese të opozitës parlamentare për llogaridhënie. Gjithashtu, ju jeni dëshmitar i refuzimit të vazhdueshëm të dhjetëra kërkesave të deputetëve të opozitës për marrjen e informacionit nga institucionet e pushtetit ekzekutiv, duke penguar kështu ushtrimin e një të drejte kushtetuese të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Edhe pse, në disa raste, ju keni ndërhyrë në përputhje me parashikimet e reja të Rregullores së Kuvendit, nuk rezulton të ketë pasur asnjë reflektim nga ana e mazhorancës, ndërsa mekanizmi i ndërhyrjes suaj ka mbetur pa efekt, duke u ndalur pikërisht në atë fazë.

2. Lidhur me vonesën e gjatë të shqyrtimit nga Kuvendi të kërkesës së SPAK-ut për heqjen e imunitetit të deputetes Belinda Balluku dhe votimin e mëvonshëm kundër nga shumica parlamentare, duke cenuar parimin e kontrollit dhe të balancës ndërmjet pushteteve, si dhe parimin e barazisë para ligjit, ju sjellim në vëmendje se përgjegjësia për këtë situatë i përket tërësisht shumicës parlamentare dhe juve personalisht. Edhe pse pesë anëtarët e opozitës në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në përputhje me të drejtën që u njeh Rregullorja e Kuvendit, kërkuan gjashtë herë mbledhjen e Këshillit për shqyrtimin e kërkesës, ju refuzuat, pa asnjë shkak të ligjshëm, të përmbushnit detyrimin tuaj sipas Rregullores së Kuvendit. Gjithashtu, në respekt të parimit të kontrollit dhe të balancës ndërmjet pushteteve dhe të barazisë para ligjit, deputetët e opozitës votuan pro kërkesës së SPAK-ut për heqjen e imunitetit të deputetes Belinda Balluku.

3. Lidhur me moszbatimin e disa vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, opozita ju ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme të respektoni shtetin e së drejtës dhe të mos cenoni autoritetin e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ju vazhdoni të refuzoni zbatimin e çdo vendimi të Gjykatës Kushtetuese që nuk përputhet me qëndrimet tuaja politike. Kujtojmë se keni refuzuar të zbatoni dy vendime të Gjykatës Kushtetuese lidhur me mandatin e deputetes Olta Xhaçka, keni refuzuar të zbatoni tri vendime të Gjykatës Kushtetuese lidhur me pagat e magjistratëve dhe, së fundmi, prej katër muajsh refuzoni të zbatoni vendimin nr. 62/2026 të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka urdhëruar ngritjen e Komisionit Hetimor të kërkuar nga opozita për shqyrtimin e shkeljes së parimit të barazisë së palëve në zgjedhjet e 11 majit 2025.

4. Lidhur me forcimin e luftës kundër korrupsionit, shumica parlamentare ka dhënë në vazhdimësi mesazhin se nuk dëshiron të distancohet nga zyrtarët e korruptuar. Mbrojtja e Belinda Ballukut ishte vetëm një prej akteve që e dëshmojnë këtë qëndrim. Një tjetër akt konkret ishte vendimi juaj personal për caktimin e deputetes Olta Xhaçka, në cilësinë e kryetares së Delegacionit Parlamentar të Shqipërisë pranë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, pasi ju kishit refuzuar të zbatonit dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me mandatin e saj. Kështu, Shqipëria paraqitet si i vetmi vend anëtar i Këshillit të Europës, delegacioni parlamentar i të cilit drejtohet nga një person i marrë zyrtarisht nën akuzë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) për veprat penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Në cilësinë time si Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ju kam kërkuar zyrtarisht rishikimin dhe shfuqizimin e këtij vendimi. Megjithatë, nga ana juaj nuk është marrë asnjë masë, duke përforcuar kështu mesazhin se korrupsioni dhe pastrimi i parave tolerohen dhe mbrohen nga kjo shumicë parlamentare dhe se nuk ekziston asnjë vullnet politik për t'u distancuar nga zyrtarët publikë të korruptuar.

5. Lidhur me shqetësimin serioz për politizimin e emërimeve në institucionet e pavarura, më lejoni t'ju sjell në vëmendje se ky është një konstatim i përsëritur në raportet e Komisionit Europian, i cili është injoruar vazhdimisht nga ana juaj. Në përgjigje të këtij shqetësimi dhe me qëllim adresimin e tij, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, përmes shkresës nr. 3759 Prot., datë 02.12.2025, ka propozuar zhvillimin e një procesi transparent për emërimin dhe zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të pavarura. Ky proces parashikonte konsultimin konstruktiv me të gjitha grupet parlamentare në Kuvend, me synim garantimin e pavarësisë së këtyre institucioneve dhe respektimin e parimit të meritokracisë. Një qasje e tillë do të krijonte premisat e nevojshme për ruajtjen e besimit të qytetarëve te këto institucione.

Megjithatë, ju e injoruat këtë propozim konstruktiv të opozitës dhe mazhoranca vijoi, në mënyrë të njëanshme, të diktojë, propozojë dhe votojë e vetme të gjitha emërimet në institucionet e pavarura. Kjo përbën një tregues të qartë të kapjes së institucioneve shtetërore nga mazhoranca qeverisëse, duke cenuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, si dhe një traditë të konsoliduar parlamentare.

6. Lidhur me shqetësimet mbi procesin legjislativ, më lejoni t'ju sjell në vëmendje se jo vetëm që mungon konsultimi real dhe efektiv me grupet e interesit, por shpeshherë as deputetëve të opozitës nuk u vihet në dispozicion koha e mjaftueshme për shqyrtimin e projektligjeve. Dëshirojmë të nënvizojmë se Kuvendi duhet të jetë forumi demokratik ku dëgjohet zëri i qytetarëve. Përmes veprimeve penguese nga ana juaj dhe e shumicës parlamentare, ju jo vetëm e keni zhbërë këtë parim të demokracisë funksionale, por vazhdimisht pengoni edhe opozitën në përmbushjen e këtij roli.

Që prej muajit qershor 2026, mijëra qytetarë shqiptarë protestojnë në mënyrë paqësore çdo ditë, duke parashtruar kërkesa politike, por edhe kërkesa që kërkojnë ndërhyrje ligjore. Në përmbushje të rolit tonë si përfaqësues të qytetarëve, që në muajin qershor 2026, ne i përkthyem kërkesat e qytetarëve protestues në një paketë ligjore, duke propozuar për miratim në Kuvend katër projektligje: projektligjin për investimet strategjike, projektligjin për zonat e mbrojtura, projektligjin për trashëgiminë kulturore dhe projektligjin për Paketën e Maleve.

Edhe pse kanë kaluar pesë muaj nga depozitimi i këtyre katër projektligjeve, mazhoranca nuk lejon as shqyrtimin e tyre, duke penguar në këtë mënyrë jo vetëm ushtrimin e të drejtave kushtetuese të deputetëve të opozitës, por, mbi të gjitha, përmbushjen e rolit të Kuvendit si institucion që duhet të dëgjojë dhe të përfaqësojë zërin e qytetarëve.

7. Lidhur me shqetësimin për produktin e njëanshëm të Komisionit Parlamentar Ad Hoc për Reformën Administrative dhe Territoriale, sjellim në vëmendjen tuaj se opozita u angazhua në mënyrë konstruktive në punën e këtij komisioni të përbashkët. Ishte mazhoranca ajo që, pa asnjë arsye të justifikuar, braktisi procesin e përbashkët dhe miratoi një produkt të njëanshëm, i cili, në kundërshtim me standardet europiane, në vend që të forconte decentralizimin, solli ricentralizimin e pushtetit.

8. Lidhur me shqetësimin se disa rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias mbeten ende të paadresuara dhe se nevojitet urgjentisht një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse, veçanërisht përpara zgjedhjeve vendore të vitit 2027, më lejoni t'ju sjell në vëmendje se opozita është e angazhuar në punën e Komisionit të përbashkët Parlamentar Ad Hoc për Reformën Zgjedhore. Megjithatë, mazhoranca vazhdon të synojë adresimin vetëm të çështjeve periferike, pa ofruar zgjidhje për shqetësimet themelore të evidentuara nga OSBE/ODIHR-i, të cilat lidhen drejtpërdrejt me garantimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të ndershme.

9. Lidhur me shqetësimin se Komisioni për Integrimin Europian nuk drejtohet më nga opozita, gjë që kufizon dialogun ndërmjet partive dhe rolin e saj në procesin e anëtarësimit, më lejoni t'ju sjell në vëmendje se përjashtimi i opozitës nga roli i saj i konsoliduar ndër vite në procesin e integrimit europian ka sjellë shndërrimin e këtij procesi nga një proces kombëtar në një proces njëpartiak. Në mënyrë të njëanshme, ju keni ndryshuar edhe mënyrën e drejtimit të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, duke sjellë si pasojë që, për herë të parë që prej krijimit të këtij

organi, ai të funksionojë prej më shumë se një viti vetëm si një forum i mazhorancës parlamentare, ku opozita e ka të pamundur të marrë pjesë. Kjo situatë është krijuar si pasojë e ndryshimit të njëanshëm, pa asnjë shkak apo arsye legjitime, të një ligji që ishte më parë rezultat i konsensusit politik.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në cilësinë tuaj institucionale, ju keni detyrimin kushtetues për të garantuar funksionimin efektiv të demokracisë parlamentare. Shpresojmë që, pas leximit me vëmendje të Raportit të Komisionit Europian, të reflektoni mbi gjetjet e tij dhe ta konsideroni atë një dokument pune, rekomandimet e të cilit duhet të zbatohen.

Ju keni detyrimin kushtetues të garantoni funksionimin demokratik të Kuvendit, veçanërisht në drejtim të:

1. Garantimit të kontrollit parlamentar dhe respektimit të mekanizmave kushtetues të kontrollit që i njihen opozitës.
2. Garantimit të një procesi transparent ligjvënës, i cili siguron të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, si dhe konsultimin efektiv dhe në kohë të mjaftueshme me të gjitha grupet e interesit.
3. Garantimit të balancës ndërmjet pushteteve, përmes sigurimit të një procesi gjithëpërfshirës për emërimet dhe zgjedhjet nga Kuvendi në institucionet e pavarura.
4. Respektimit të autoritetit të Gjykatës Kushtetuese, përmes zbatimit në kohë të vendimeve të saj.
5. Garantimit të gjithëpërfshirjes në procedurat parlamentare që lidhen me reformat e nevojshme për procesin e integrimit europian.
6. Rikthimit të rolit të opozitës në procesin e integrimit europian dhe në strukturat parlamentare që e mbështesin dhe e mbikëqyrin këtë proces.
7. Garantimit të shqyrtimit në kohë të iniciativave ligjore të deputetëve të opozitës.

Më lejoni t'ju sjell në vëmendje se qëndrimi politik i shumicës për të bllokuar çdo të drejtë kushtetuese të opozitës, refuzimi i iniciativave të saj ligjore, përjashtimi nga procesi i emërimeve në institucionet e pavarura, si dhe përjashtimi nga procesi i integrimit europian, e bëjnë rolin e deputetëve të opozitës në Parlament jo vetëm të papërfillshëm, por e shndërrojnë atë në një fasadë të një normaliteti të rremë, që minon vetë parimet dhe standardet minimale të parlamentarizmit demokratik.

Kjo situatë vë seriozisht në pikëpyetje vetë qëllimin e vazhdimit të pranisë së opozitës në Parlament. Nëse opozita nuk mund të diskutojë çështje me interes publik, nuk mund të ushtrojë mbikëqyrje mbi veprimtarinë e qeverisë, nuk mund të propozojë ligje apo amendamente në dobi të qytetarëve, nuk mund të marrë informacion me shkrim nga institucionet dhe, nëse të drejtat e saj kushtetuese shpërfillen në mënyrë të vazhdueshme, atëherë roli i saj reduktohet në një rol thjesht formal, duke e penguar të përmbushë përgjegjësitë që i takojnë në një demokraci parlamentare funksionale.

Dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se, ndonëse mbetemi të përkushtuar për të vepruar brenda kuadrit institucional dhe demokratik, nuk do të pranojmë kurrë asgjësimin e parlamentarizmit apo mohimin e të drejtave tona kushtetuese.

Një vend që synon anëtarësimin në Bashkimin Europian, por që shkel rregullat themelore të bashkëjetesës demokratike brenda Parlamentit, ku shumica dhe opozita kanë rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, nuk mund të pretendojë se ka ndërtuar një demokraci funksionale, përtej një propagande që paraqet një normalitet të rremë.

Ne dëshirojmë që Shqipëria të ecë drejt Bashkimit Europian jo përmes propagandës boshe, por përmes respektimit të standardeve të mirëfillta demokratike dhe funksionimit të institucioneve mbi bazën e këtyre standardeve, duke nisur pikërisht nga institucioni që përbën një nga shtyllat themelore të Republikës sonë: Kuvendi i Shqipërisë.

Ju urojmë lexim të mbarë të Raportit SWD(2026) 690, datë 4.11.2026, të Komisionit Europian për Shqipërinë.

Gazment BARDHI

KRYETAR
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE